

SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA

KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës  
ŽALBENO VEĆE KAI

GSK-KPA-A-107/13

Prishtinë,

31 janar 2014

Në çështjen juridike të

**V. Đ.**

Mali i Zi

*Pala ankuese*

**kundër**

Nuk dihet

*Pala përgjegjëse në ankesë*

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Elka Filcheva- Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Dag Brathole dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/162/2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA53033), të datës 5 shtator 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 31 janar 2014, mori këtë

## AKTGJYKIM

Hedhet poshtë si e pasafatshme ankesa e V. Đ. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/162/2012 (lënda regjistruar në AKP me numrin KPA53033), të datës 5 shtator 2012.

### Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 2 nëntor 2007, V. Đ. ka paraqitur dy kërkesa në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP).
2. Në kërkesën e parë, Đ. ka kërkuar pronësinë e ngastrës nr. 1753/2 në zonën kadastrale nr. 71611015 të Vitomicës, Komuna e Pejës. Sipas fletës poseduese nr. 1352 sipërfaqja përbëhet prej 680 m<sup>2</sup>. Kësaj kërkesë i është dhënë nr. KPA53032 nga AKP-ja.
3. Në kërkesën e dytë, e cila ishte dorëzuar në të njëjtën ditë, Đ. ka kërkuar pronësinë e një objekti banesor prej 160 m<sup>2</sup> në të njëjtën pronë. Kësaj kërkesë i është dhënë nr. KPA53033 AKP-ja
4. Njoftim i kërkesës është bërë pwr kwtw pronw tw paluajtshme më 31 janar 2008. Nga fotografitë e bërë të njëjtën ditë, është dokumentuar se objekti banesor ishte shkatërruar.
5. Kërkesat nuk ishin të kontestuara dhe më 5 shtator 2012, që të dy kërkesat ishin miratuar nga Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (KKPK) me vendimin grupor nr. KPCC/D/A/162/2012 respektivisht KPCC/D/R/162/2012.
6. Vendimet i ishin dorëzuar D. më 14 dhjetor 2012. Ai ka paraqitur ankesë kundër vendimit grupor KPCC/D/R/162/2012 (lëndët e regjistruara në AKP me numrin KPA53033) në Kolegjin e Apeli të Gjykatës Supreme më 26 prill 2013. Ankesa është pranuar nga AKP-ja më 8 maj 2013.
7. AKP-ja ka theksuar se ankesa i referohet të dy vendimeve. Megjithatë, nga formulimi është e qartë se ajo i referohet vetëm vendimit the KPCC/D/R/162/2012 (lëndët e regjistruara në AKP me numrin KPA53033), që ka të bëjë me objektin në pronë.

### Pretendimet e palës ankuese

8. V. Đ. nuk kundërshton vendimin e marrë nga KKPK-ja për sa i përket pronësisë së pronave.

9. Megjithatë, D. kërkon kompensim për dëmet fizike për shkak të shkatërrimit të pronës si rezultat i konfliktit të armatosur në Kosovë. D. ka cekur se KKPK-ja e ka shpallur vetëm jo-kompetente për të vendosur për kërkesëpadinë, por thekson se KKPK-ja nuk e ka udhëzuar paraqitësin e kërkesës se në çfarë mënyrë të kërkojë kompensim për dëmin fizik.

#### **Arsyetim ligjor**

10. Ankesa është e pasafatshme. Ajo nuk është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh siç parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë pronën Bujqësore dhe atë Komerciale të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079. Prandaj, ankesa është hedhur poshtë si e pasafatshme.
11. Gjykata Supreme gjen *obiter dictum* se ankesa do të refuzohej si e pabazuar edhe po të mos kishte qenë e pa-afatshme, sepse neni 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 nuk i jap KKPK-së kompetencë për tu marrë me kompensim. Një kërkesë e tillë mbase do të duhej të paraqitej në gjykatat e rregullta të Kosovës.
12. Prandaj, rrjedhimisht mbi të mësipërmen sipas dispozitës së nenit nenin 13.3 nën (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### **Këshillë juridike:**

13. Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet.

***Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX***

***Dag Brathole, Gjyqtar i EULEX-it***

*Sylejman Nuredini, Gjyqtar*

*Holger Engelmann, Referent i EULEX-it*